



Formulari i pyetjeve më të shpeshta (FAQ) për “Pay It Off” 2026

(Albanian)

Shënim: Për t’u kualifikuar për “Pay It Off”, prindërit jokujdestarë duhet të kenë një borxh të përhershëm kundrejt Departamentit të Shërbimeve Sociale të Qytetit të Nju-Jorkut (NYC Department of Social Services, NYC DSS). Shikoni FAQ nr. 3 për më shumë informacion.

1. Pse e mora këtë fletëthirrje?

Ju e keni marrë këtë fletëthirrje sepse në kohën kur ju është dërguar me postë, keni pasur një borxh prej të paktën \$1,000 për mbështetje financiare për fëmijën dhe të paktën \$500 nga këto i detyrohen qeverisë/Departamentit të Shërbimeve Sociale të Qytetit të Nju-Jorkut (Department of Social Services, DSS). Qyteti i Nju-Jorkut po ju bën një ofertë me afat të kufizuar për t’ju ndihmuar ta reduktoni shumën e borxhit që keni për mbështetjen financiare për fëmijën.

2. Si funksionon ky program?

Nga data 2 mars 2026 deri më 13 mars 2026, bëni një pagesë prej minimumi \$500 dhe nënshkruani e dërgoni marrëveshjen e “Pay It Off”. Më pas, Zyra e Shërbimeve të Detyrimit për Ushqim për Fëmijën (NYC Office of Child Support Services (OCSS)) do ta rakordojë pagesën tuaj duke e reduktuar borxhin me të njëjtën shumë (deri në shumën që detyroheni).

Më poshtë jepet një shembull:



SEMBOL	Pagesa “Pay It Off” e bërë mes datave 2 mars dhe 13 mars, 2026	\$600
Plus (+)	Shuma e rakorduar	\$600
Totali (=)	Shuma totale e reduktuar nga borxhi kundrejt qeverisë/DSS-së	\$1,200

3. Çfarë nënkupton borxhi i përhershëm kundrejt Departamentit të Shërbimeve Shoqërore të Qytetit të Nju-Jorkut (DSS)?

Është një borxh për detyrimin për ushqim për fëmijën kundrejt DSS-së kur një fëmijë merr ndihmë ekonomike dhe prindi jokujdestar mbetet mbrapa me pagesat kundrejt urdhrit të gjykatës.

4. Si mund të paguaj?

Cilado qoftë mënyra që zgjidhni për të paguar, ne nuk mund ta rakordojmë një pagesë pa marrë një marrëveshje të nënshkruar të “Pay It Off”. Për të marrë një kredi, kërkohet një marrëveshje e veçantë për secilin rast.

Ka katër mënyra pagese:

- 1) **Personalisht** me çek, kartë krediti/debiti ose urdhër-pagesë -
151 W. Broadway, 5th floor
New York, NY 10013
E hënë - e premte, 09:00 - 17:00 (përveç pushimeve zyrtare dhe fundjavave)

Mund të vizitoni edhe një nga pesë vendndodhjet e zyrave tona të OCSS-së në Gjykatën e
Çështjeve Familjare dhe ta kryeni pagesën me kartë krediti/debiti:
<https://on.nyc.gov/contactocss>.
- 2) **Online** duke përdorur aplikacionin celular për detyrimin për ushqim për fëmijën NYC ACCESS
HRA: www.nyc.gov/childsupportmobile
- 3) **Me postë** një çek ose urdhër-pagesë në -
OCSS - Pay It Off
PO Box 830
Canal Street Station
New York, NY 10013
- 4) **Telefononi** në numrin 929-252-5201 mes orareve 09:00 - 17:00 për të bërë një pagesë me kartë
kredit/debiti nga telefoni.
 - Që të merrni kreditin, pagesat duhet të merren jo më vonë se data 13 mars 2026.
Mësoni më shumë rreth mënyrave të pagesës në
<https://on.nyc.gov/paymentmethods>.
 - Pagesat duhet të shoqërojnë marrëveshjen.
 - Kur keni disa raste, kryejini pagesat më vete për secilin rast dhe lidhni marrëveshje të veçanta.
 - Bëjini çeqet të pagueshme për llogari të "Qendrës së Përpunimit të Detyrimit për Ushqim për Fëmijën në shtetin e Nju-Jorkut" (NYS Child Support Processing Center).
 - Përfshini ID-në e rastit tuaj të detyrimit për ushqim për fëmijën dhe tregoni "Pay It Off" në pagesën tuaj.



SHËNIM: Pagesat e mbledhura nga konfiskimi (si p.sh. sigurimi i papunësisë dhe konfiskimi i pagës/urdhri për mbajtjen e të ardhurave (IWO)), sekuestrimi ose rimbursimi i taksave **nuk** do të rakordohen.

5. Përse unë nuk kualifikohem për programin nëse unë i detyrohem vetëm prindit kujdestar dhe jo DSS-së?

OCSS ka autoritetin të reduktojë në rrugë administrative vetëm borxhin e detyruar ndaj qeverisë/DSS-së së Nju-Jorkut.

Nëse keni borxhe të detyruara vetëm ndaj prindit kujdestar, nuk mund të merrni pjesë. Pjesëmarrja në një program ndërmjetës mund të nxisë biseda me prindin kujdestar për të marrë në konsideratë reduktimin e borxhit të detyruar ndaj atyre. Referojuni fletushkës "Shërbimet e ndërmjetësimit" në faqen tonë të internetit: bit.ly/MediationBrochure.

6. Po nëse unë nuk mund të paguaj një minimum prej \$500?

Ky program në veçanti kërkon që ju të paguani një minimum prej \$500 të detyrimeve të prapambetura për të përfituar nga oferta me kohë të kufizuar.

Megjithatë, çdo pagesë e borxhit tuaj të detyrimit për ushqim për fëmijën do t'ju japë përfitime në mënyra të tjera. Ju mund të shmangni veprime të tjera përkatëse të ekzekutimit të detyrueshëm. Ju gjithashtu, mund të regjistroheshi në Programin tonë të Kreditit të Detyrimeve të Prapambetura (Arrears Credit Program), i cili kërkon që të paguani detyrimin tuaj të detyrimit për ushqim për fëmijën me urdhër gjykatë për një vit dhe në fund të përfitoni një reduktim borxhi deri në \$5,000. Nëse regjistroheshi gjatë periudhës së "Pay It Off", ju do të përfitoni një reduktim shtesë prej deri në \$2,500. Mund të zbuloni më shumë rreth këtij programi te pyetjet e mëposhtme FAQ nr. 7 dhe nr. 8.

7. Çfarë është Programi i Kreditit të Detyrimeve të Prapambetura?

Programi i Kreditimit të Detyrimeve të Prapambetura (Arrears Credit Program, ACP) ju lejon të kualifikoheni për një reduktim të borxhit deri në \$5,000 kundrejt pagesave të prapambetura të përhershme të regjistruara në DSS, pasi të keni paguar në mënyrë të vazhdueshme të gjithë shumën e detyrueshme me urdhër gjykatë për një vit të tërë (12 muaj), duke nisur nga dita që nënshkruani marrëveshjen e Programit të Kreditimit të Detyrimeve të Prapambetura. Ju mund të kualifikoheni për deri në 3 vite dhe ta reduktoni borxhin deri në \$15,000 në total.

Nëse regjistroheshi në Programin e Kreditit të Detyrimeve të Prapambetura në të njëjtën kohë që merrni pjesë në "Pay It Off" dhe jeni të kualifikueshëm, ju kualifikoheni për një reduktim shtesë prej deri në \$2,500 të borxhit të detyruar ndaj qeverisë/DSS-së.

Më poshtë jepet një shembull:



SHSEMBULL	Pagesat e bëra mes datave 2 mars dhe 13 mars 2026	\$500
Plus (+)	Shuma e rakorduar	\$500
	Marrëveshja e nënshkruar e Kreditit të Detyrimeve të Prapambetura	
Plus (+)	Prapambetura	\$2,500
Totali (=)	Totali i përdorur për reduktimin e borxhit ndaj qeverisë/DSS-së gjatë PIO-s	\$3,500

Çdo vit, për tre vjet, do të reduktohet një shumë shtesë prej deri në \$5,000 e borxhit kur veproni në përputhje me Programin e Kreditit të Detyrimeve të Prapambetura.

Për prindërit që nuk kanë kujdestarinë e fëmijës dhe kanë llogari të shumëfishta, kreditimet mund të aplikohen në secilën llogari individuale sipas rastit (deri në shumën e borxhit).

8. A do të thotë kjo që unë marr një reduktim prej \$2,500 ndaj detyrimeve të prapambetura nëse regjistrohem në Programin e Kreditit të Detyrimeve të Prapambetura kur regjistrohem për "Pay It Off"?

Po. Reduktimi shtesë deri në \$2,500 i borxheve për nënshkrimin e një marrëveshjeje ACP gjatë "Pay It Off" është i menjëhershëm. Duhet një vit (12 muaj) pagesash konsistente dhe të plota të detyrimit për ushqim për fëmijën që të merrni kreditin shtesë prej deri në \$5,000 për të cilin kualifikoheni në fund të vitit. Ai vit fillon në ditën kur ju nënshkruani marrëveshjen për Programin e Kreditit të Detyrimeve të Prapambetura. Ju mund të kualifikoheni për deri në 3 vite dhe të fitoni një kredit prej \$15,000 në total.

9. A mund të kryej më shumë se një pagesë mes datës 2 mars dhe 13 mars 2026? Për shembull, nëse paguaj \$1,000 në javën e parë të programit dhe në javën e dytë të programit mundem të bëj një pagesë tjetër prej \$1,000, a mund të kryej dy pagesa?

Po, mund të bëni më shumë se një pagesë mes datës 2 mars dhe 13 mars 2026 për aq kohë sa pagesat merren brenda datës 13 mars 2026 dhe të gjitha se bashku janë më shumë se \$500 dhe ju nënshkruani dhe dërgoni një marrëveshje për pagesë brenda datës së përfundimit të programit. Shihni FAQ nr. 4 për udhëzime mbi kryerjen e pagesave të kualifikuara.

10. Si mund të dorëzoj marrëveshjen e “Pay It Off” dhe/ose aplikimin për Programin e Kreditit të Detyrimeve të Prapambetura?

Mund të merrni një kopje të marrëveshjes së “Pay It Off” dhe ta dërgoni si në vijim:

1. Shkarkoni marrëveshjen e “Pay It Off” në <https://nyc.gov/payitoff>. Mund ta keni marrë një kopje me postë.
2. Plotësoni dhe nënshkruani marrëveshjen. Për të marrë një kredi, kërkohet një marrëveshje e veçantë **për secilin rast**.
3. Dërgoni marrëveshjen dhe një kopje të ID-së suaj me fotografi në mënyrat e mëposhtme:
Me email te dcse.cseweb@dfa.state.ny.us, sigurohuni që të përfshini emrin tuaj të plotë, ID-në e rastit, dhe “Pay It Off” në email.

Me postë te:

OCSS – Pay It Off
PO Box 830
Canal Street Station
New York, NY 10013

Personalisht në adresën:

151 W. Broadway, 4th floor
New York, NY 10013
E hënë - e premte, 08:00 - 18:00 (përveç pushimeve zyrtare dhe fundjavave)
Ose vizitoni cilëndo nga zyrat e OCSS-së në Gjykatat për Familjen.



Mund ta shkarkoni aplikimin për Programin e Kreditit të Detyrimeve të Prapambetura nga bit.ly/ArrearsCreditApp. Dërgojeni siç udhëzohet më sipër me marrëveshjen e “Pay It Off”.

11. Çfarë ndodh nëse dorëzoj vetëm pagesën/pagesat e mia pa lidhur ndonjë marrëveshje?

Ju nuk do të kualifikoheni për procesin e rakordimit të “Pay It Off” pa nënshkruar një marrëveshje. Duhet ta plotësoni, nënshkruani dhe ktheni marrëveshjen para datës 13 mars 2026. Shihni FAQ nr. 10.

12. Sa është shuma e borxhit që detyrohem?

Kontaktoni OCSS-në për të zbuluar balancën e llogarisë suaj:



- **EMAIL** dcse.cseweb@dfa.state.ny.us. Ju lutemi të përfshini emrin tuaj të plotë dhe numrin e çështjes së mbështetjes financiare për fëmijët ose datën e lindjes në kërkesën tuaj nëpërmjet email-it dhe vendosni Pay It Off në rreshtin e subjektit.
- **KËRKONI** një takim telefonik me një punonjës të Shërbimit ndaj Klientit duke dërguar një email në adresën dcse.cseweb@dfa.state.ny.us. Jepni emrin tuaj, numrin e çështjes së detyrimit për ushqim për fëmijën ose datëlindjen, një përshkrim të shqetësimit (-ve), numrin e telefonit dhe orarin kur preferoni t'ju kontaktojmë. Përdorni subjektin "Kërkesë për takim me Shërbimin ndaj Klientit" në emailin tuaj.
- **TELEFONONI** 888-208-4485, Linjën Telefonike të Ndhmës për Detyrimin për Ushqim për Fëmijën në Shtetin e Nju-Jorkut.
- **NA DËRGONI NJË LETËR** në adresën OCSS, Pay it Off, PO Box 830, Canal Street Station, New York, NY 10013.
- **VIZITONI** 151 W. Broadway, 4th floor, New York, NY 10013 (E hënë - e premte, 08:00 - 18:00, përveç pushimeve zyrtare dhe fundjavave)
Ose vizitoni cilëndo nga zyrat e OCSS-së në Gjykatat për Familjen.

13. Nëse paguaj \$500, sa është shuma që do të kreditohet për borxhin tim?

Kjo varet nga rasti juaj specifik. Për shembull, nëse paguani \$500, borxhi juaj mund të reduktohet nga \$1,000 deri në shumën që detyroheni. Shembulli në FAQ nr. 2 dhe 7 mund t'ju ndihmojnë.

14. Kush i merr paratë nëse kam një borxh kundrejt DSS-së dhe prindit kujdestar?

Paratë do të shpërndahen në përputhje me rregullat federale të shpërndarjes. Për të mësuar më shumë rreth detajeve të çështjes suaj, ju mund të:

- **DËRGONI NJË EMAIL NË** dcse.cseweb@dfa.state.ny.us. Ju lutemi të përfshini emrin tuaj të plotë dhe numrin e çështjes së detyrimit për ushqim për fëmijën ose datëlindjen në kërkesën tuaj me email. Dikush do t'ju telefonojë ose do t'ju kthejë përgjigje me postë.
- **KËRKONI** një takim telefonik me një punonjës të Shërbimit ndaj Klientit duke dërguar një email në adresën dcse.cseweb@dfa.state.ny.us. Jepni emrin tuaj të plotë, numrin e çështjes së detyrimit për ushqim për fëmijën ose datëlindjen, një përshkrim të shqetësimit (-ve), numrin e telefonit dhe orarin kur preferoni t'ju kontaktojmë. Përdorni subjektin "Pay It Off Kërkesë për takim me Shërbimin ndaj Klientit" në emailin tuaj.
- **TELEFONONI** 888-208-4485, Linjën Telefonike të Ndhmës për Detyrimin për Ushqim për Fëmijën në Shtetin e Nju-Jorkut.
- **NA DËRGONI NJË LETËR** në adresën OCSS – Pay It Off, PO Box 830, Canal Street Station, New York, NY 10013.
- **VIZITONI** 151 W. Broadway, 4th floor, New York, NY 10013 (E hënë - e premte, 08:00 - 18:00, përveç pushimeve zyrtare dhe fundjavave)
VIZITONI cilëndo nga zyrat e OCSS-së në Gjykatat për Familjen.

15. Nëse i detyrohem para një shteti tjetër ose një konteje tjetër, a jam ende i kualifikueshëm për programin?

Jo, kualifikueshmëria për këtë program është e kufizuar te paratë që i detyroheni qeverisë së qytetit të Nju-Jorkut/Departamentit të Shërbimeve Shoqërore (DSS).

16. A jam i kualifikueshëm për të marrë pjesë në programin “Pay It Off” këtë vit nëse kam marrë pjesë në vitet e mëparshëm?

Po.

17. Çfarë ndodh nëse kam një shumë parash të përcaktuar nga gjykata me interes të pagueshëm për DSS-në?

Nëse principali i parave të përcaktuara nga gjykata që i detyroheni DSS-së së NYC pa interesa paguhet në shumën e plotë, atëherë OCSS-ja do ta eliminojë të gjithë interesin që i detyroheni.

18. Nëse e paguaj principalin e plotë të parave të përcaktuara nga gjykata që i detyrohem DSS-së, a do të eliminohet i gjithë interesi im?

Po.

A keni ndonjë problem shëndetësor ose problem me shëndetin mendor apo aftësi të kufizuara?

A jua vështirëson kjo gjendje të kuptuarit e këtij njoftimi apo kryerjen e veprimeve që ju kërkohen nëpërmjet këtij njoftimi? A jua vështirëson kjo gjendje përfitimin e shërbimeve të tjera në HRA?

Ne mund t'ju ndihmojmë. Na telefononi në numrin 718-557-1399. Gjithashtu, ju mund të kërkonit ndihmë duke u paraqitur pranë një zyre të HRA-së. Ju gëzoni të drejtën ta kërkonit këtë lloj ndihme në përputhje me ligjin.